



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISËDHE MBROJTJES SOCIALE
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

Nr. 1636 prot

Tiranë, më 13/09 2021

URDHËR

Nr. 246, datë 13/09 2021

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR.722, DATË 11.11.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E MASËS,TË KRITEREVE, PROCEDURAVE E DOKUMENTACIONIT PËR VLERËSIMIN DHE PËRFITIMIN E AFTËSISË SË KUFIZUAR E TË NDIHMËSIT PERSONAL DHE TË STRUKTURAVE PËRGJEGJËSE E TË DETYRAVE TË TYRE",

Bazuar në ligjin nr.57, datë 18.07.2019, "Për Asistencën Sociale në RSH", pikat 4 dhe 16 të kreut IV, të VKM nr.722, datë 11.11.2019, "Për përcaktimin e masës,procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre ", gërmat a, b, c dhe ç, të pikës 2 të kreut IV të VKM nr.431, datë 08.06.2016, "Për përcaktimin e masës,procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot "si dhe VKM nr. 135, datë 07.03.2018 "Për miratimin e statutit të Shërbimit Social Shtetëror",

URDHËROJ:

- 1.Pagesa bazë për shkak të aftësisë së kufizuar , të përcaktuar në pikën 2, të kreut IV,të VKM nr.722, date 11.11.2019 , është 11.765 (njëmbëdhjetëmijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë në muaj.
- 2.Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2 gërma " a", të kreut IV,të VKM nr.431, datë 08.06.2016 , të ndryshuar, për të rritur dhe fëmijë, është 7059 (shtatëdhjetë e nëntë) lekë në muaj, për personat e përcaktuar në pikën 2, të kreut I të vendimit.
- 3.Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2 gërma " b", të kreut IV,të VKM nr.431, datë 08.06.2016 , të ndryshuar, për të rritur dhe fëmijë, është 9412 (nëntë mijë e katërqind e dymbëdhjetë) lekë në muaj, për personat e përcaktuar në pikën 2, të kreut I të vendimit.

4. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2 gërma “c”, të kreut IV, të VKM nr.431, datë 08.06.2016 , të ndryshuar, për të rritur dhe fëmijë, është 11.765 (njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë në muaj, për personat e përcaktuar në pikën 2, të kreut I të vendimit.

5. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2 gërma “ç”, të kreut IV, të VKM nr.431, datë 08.06.2016 , të ndryshuar, për të rritur dhe fëmijë, është 14.118 (katërmëdhjetë mijë e njëqind e tetëmbëdhjetë) lekë në muaj, për personat e përcaktuar në pikën 2, të kreut I të vendimit.

6. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 16, të kreut IV, të VKM nr.431, datë 08.06.2016 , të ndryshuar, për shërbimet gjithëpërfshirëse të ndihmësit personal, është 14.118 (katërmëdhjetë mijë e njëqind e tetëmbëdhjetë) lekë në muaj, për personat e përcaktuar në pikën 2, të kreut I të vendimit.

7. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 17, të kreut IV, të VKM nr.431, datë 08.06.2016 , të ndryshuar, për shërbimet herëpashershme të ndihmësit personal, është 9412 (nëntë mijë e katërqind e dymbëdhjetë) lekë në muaj, për personat e përcaktuar në pikën 2, të kreut I të vendimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga 01.09.2021.



DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Luneda Sufali